
RREGULLORE (KE) NR. 1931/2006 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, DATË 20 DHJETOR 2006, "PËR RREGULLAT MBI TRAFIKUN LOKAL KUFITAR NË KUFIJTË E JASHTËM TOKËSORË TË SHTETEVE ANËTARE DHE QË NDRYSHON DISPOZITAT E KONVENTËS SË SHENGENIT"

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Evropian dhe në veçanti nenin 62, paragrafi 2, germa "a" të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit,

Duke vepruar në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 251 të traktatit¹,

Meqë:

1. Në Komunikatën e Komisionit me titull "Drejt menaxhimit të integruar të kufijve të jashtëm të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian" u theksua nevoja për të hartuar rregulla mbi trafikun lokal kufitar me qëllim konsolidimin e kuadrit ligjor të BE-së për kufijtë e jashtëm. Kjo nevojë u konfirmua nga Këshilli më 13 qershor 2002, me miratimin e "Planit për menaxhimin e kufijve të jashtëm të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian", në vijim nënshkruar nga Këshilli Evropian në Sevilde më 21 dhe 22 qershor 2002.

2. Është në interes të zgjerimit të Bashkimit Evropian të garantohet që kufijtë me fqinjët e tij të mos jenë pengesë për shkëmbimet tregtare, shoqërore dhe kulturore ose bashkëpunimin rajonal. Si rrjedhojë, duhet të zhvillohet një sistem efikas për trafikun lokal kufitar.

3. Regjimi i trafikut lokal kufitar përbën një derogim nga rregullat e përgjithshme që rregullojnë kontrollin kufitar të personave që kalojnë kufijtë e jashtëm, të cilat janë parashikuar në Rregulloren (KE) nr. 562/2006 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 15 mars 2006, "Për vendosjen e një Kodi komunitar për rregullat që rregullojnë lëvizjen e personave përtej kufijve (Kodi për Kufijtë e Shengenit)"².

4. Komuniteti duhet të parashikojë kritere dhe kushte që duhet të përmbushen me qëllim lehtësimin e kalimit të kufirit të jashtëm tokësor të rezidentëve kufitarë, sipas regjimit të trafikut lokal kufitar. Këto kritere dhe kushte duhet të garantojnë një balancë mes, nga njëra anë, lehtësimit të kalimit kufitar për rezidentët e zonës kufitare në mirëbesim që kanë arsye të ligjshme për të kaluar rregullisht një kufi të jashtëm tokësor dhe, nga ana tjetër, nevojës për të parandaluar imigracionin e paligjshëm dhe kërcënimet e mundshme ndaj sigurisë të shkaktuara nga veprimtaritë kriminale.

5. Si rregull i përgjithshëm, për të parandaluar abuzimet, lejet e trafikut lokal kufitar duhet t'ju lëshohen vetëm atyre personave që kanë qenë rezidentë të ligjshëm në zonën kufitare për të paktën një vit. Marrëveshjet dypalëshe të lidhura ndërmjet shteteve anëtare dhe vendeve të treta fqinje mund të parashikojnë një periudhë më të gjatë qëndrimi. Në raste të veçanta dhe të

justifikuara, siç janë ato që kanë të bëjnë me të miturit, ndryshimet në gjendjen civile ose trashëgiminë e tokës, këto marrëveshje dypalëshe mund të parashikojnë gjithashtu një periudhë më të shkurtër qëndrimi.

6. Lejet e trafikut lokal kufitar duhet t'u lëshohen rezidentëve kufitarë pavarësisht nëse janë ose jo objekt i kërkesave për vizë në përputhje me Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 539/2001, 15 mars 2001, "Për caktimin e vendeve të treta shtetasit e të cilave duhet të jenë të pajisur me vizë kur kalojnë kufijtë e jashtëm dhe të vendeve shtetasit e të cilave përjashtohen nga kjo kërkesë"³. Si rezultat, kjo rregullore duhet të lexohet së bashku me Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1932/2006, datë 21 dhjetor 2006, "Për ndryshimin e Rregullores (KE) nr. 539/2001"⁴, e cila është hartuar për të përjashtuar nga detyrimi i vizave rezidentët kufitarë që përfitojnë nga regjimi i trafikut lokal kufitar i parashikuar në këtë rregullore. Si rrjedhojë, kjo rregullore mund të hyjë në fuqi njëkohësisht me këtë rregullore ndryshuese.

7. Komuniteti duhet të parashikojë kritere dhe kushte të veçanta për lëshimin e lejeve të trafikut lokal kufitar për rezidentët kufitarë. Këto kritere dhe kushte duhet të jenë në përputhje me kushtet e hyrjes të vendosura për rezidentët kufitarë që kalojnë një kufi të jashtëm tokësor sipas regjimi të trafikut lokal kufitar.

8. E drejta për lëvizje të lirë që gëzohet nga qytetarët e Bashkimit Evropian dhe anëtarët e familjeve të tyre dhe të drejtat e barasvlershme që gëzohen nga shtetasit e vendeve të treta dhe anëtarët e familjeve të tyre sipas marrëveshjeve ndërmjet BE-së dhe shteteve të saj anëtare, nga njëra anë, dhe vendeve të treta përkatëse, nga ana tjetër, nuk duhet të cenohen nga vendosja e rregullave për trafikun lokal kufitar në nivel BE-je. Megjithatë, kur lehtësohet kalimi kufitar sipas regjimit të trafikut lokal kufitar për rezidentët kufitarë dhe, nëse diçka e tillë përbën kontroll të rregullt më të pakët, kalimi i kufirit duhet të lehtësohet automatikisht për çdo person që gëzon të drejtën e lëvizjes në Komunitet dhe që qëndron në zonën kufitare përkatëse.

9. Për zbatimin e regjimit të trafikut lokal kufitar, shtetet anëtare duhet të lejohen të mbajnë dhe nënshkruajnë, nëse është e nevojshme, marrëveshje dypalëshe me vendet e treta fqinje, me kusht që këto marrëveshje të jenë në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë rregullore.

10. Kjo rregullore nuk cenon masat specifike që zbatohen në Seuta dhe Melijë, siç përmendet në Deklaratën e Mbretërisë së Spanjës për qytetet e Seutës dhe Melijës në Aktin Final të Marrëveshjes për Anëtarësimin e Mbretërisë së Spanjës në Konventën që zbaton Marrëveshjen e Shengenit të 14 qershorit 1985, ndërmjet qeverive të shteteve të Bashkimit Ekonomik të Beneluksit, Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Francës për shfuqizimin gradual të verifikimeve në kufijtë e tyre të përbashkët, e nënshkruar më 19 qershor 1990⁵.

11. Sanksionet e parashikuara në legjislacionin e brendshëm duhet të vendosen nga shtetet anëtare ndaj rezidentëve kufitarë që abuzojnë me regjimin e trafikut lokal kufitar të përcaktuar në këtë rregullore.

12. Komisioni duhet t'i paraqesë një raport Parlamentit Evropian dhe Këshillit për zbatimin e kësaj rregulloreje. Raporti, kur është e nevojshme, duhet të shoqërohet me propozime legjislative.

13. Kjo rregullore respekton të drejtat dhe liritë themelore dhe ndjek parimet e njohura veçanërisht nga Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian.

14. Meqenëse objektivi i kësaj direktive, konkretisht parashikimi i kritereve dhe kushteve për krijimin e një regjimi të trafikut lokal kufitar në kufijtë e jashtëm tokësorë ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në tërësinë e legjislacionit të BE-së për kufijtë e jashtëm dhe kështu ai nuk mund të arrihet mjaftueshëm kur shtetet anëtare veprojnë të vetme, dhe si rrjedhojë, për arsye të shkallës dhe të ndikimeve të kësaj rregulloreje mund të arrihet më mirë në nivel Komuniteti, ky i fundit mund të miratojë masa në përputhje me parimin e subsidiaritetit, siç përcaktohet në nenin 5 të Traktatit për themelimin e Bashkimit Evropian. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit, sipas përcaktimit në atë nen, kjo rregullore nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e këtij objektivi.

15. Në përputhje me nenet 1 dhe 2 të Protokollit për qëndrimin e Danimarkës, që i bashkëlidhet si shtojcë Traktatit të Bashkimit Evropian dhe Traktatit themelues të Komunitetit Evropian, Danimarka nuk merr pjesë në miratimin e kësaj Rregulloreje dhe nuk i nënshtrohet detyrimeve apo zbatimit të saj. Duke qenë se kjo rregullore bazohet në tërësinë e legjislacionit të Shengenit, sipas dispozitave të titullit IV të pjesës tre të Traktatit themelues të Bashkimit Evropian, Danimarka, në përputhje me nenin 5 të këtij protokoll, vendos brenda një periudhe gjashtë mujore pas datës së miratimit të kësaj rregulloreje nëse ajo do ta zbatojë ose jo atë në legjislacionin e saj të brendshëm.

16. Për sa i përket Islandës dhe Norvegjisë, kjo rregullore përbën një zhvillim të dispozitave të tërësisë së legjislacionit të Shengenit, sipas kuptimit të marrëveshjes së lidhur ndërmjet Bashkimit Evropian, Republikës së Islandës dhe Mbretërisë së Norvegjisë lidhur me asociimin e këtyre të fundit në implementimin, zbatimin dhe zhvillimin e tërësisë së legjislacionit të Shengenit⁶, të cilat përfshihen në fushën e përmendur në nenin 1, germa "A" të Vendimit të Këshillit 1999/437/KE, datë 17 maj 1999⁷ "Për disa rregulla lidhur me zbatimin e asaj marrëveshjeje".

17. Kjo rregullore përfaqëson një zhvillim të dispozitave të tërësisë së legjislacionit të Shengenit, ku Mbretëria e Bashkuar nuk merr pjesë, në përputhje me Vendimin e Këshillit 2000/365/KE, datë 29 majit 2000, "Për kërkesën e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për të marrë pjesë në disa prej dispozitave të tërësisë së legjislacionit të Shengenit"⁸. Për rrjedhojë, Mbretëria e Bashkuar nuk merr pjesë në miratimin e këtij legjislacioni dhe nuk i nënshtrohet detyrimeve apo zbatimit të tij.

18. Kjo rregullore përbën një zhvillim të dispozitave të tërësisë së legjislacionit të Shengenit në të cilin Irlanda nuk merr pjesë, në përputhje me Vendimin e Këshillit 2002/192/KE, datë 28 shkurt 2002, "Për kërkesën e Irlandës për të marrë pjesë në disa prej dispozitave të tërësisë së legjislacionit të Shengenit"⁹. Për rrjedhojë, Irlanda nuk merr pjesë në miratimin e këtij legjislacioni dhe nuk i nënshtrohet detyrimeve apo zbatimit të tij.

19. Për sa i përket Zvicrës, kjo rregullore përbën një zhvillim të dispozitave të tërësisë së legjislacionit të Shengenit sipas kuptimit të marrëveshjes së lidhur ndërmjet Bashkimit Evropian, Komunitetit Evropian dhe Konfederatës së Zvicrës për asociimin e Konfederatës së Zvicrës në implementimin, zbatimin dhe zhvillimin e tërësisë së legjislacionit të Shengenit, të cilat

përfshihen në fushën e përmendur në nenin 1, germa "A", të Vendimit 1999/437/KE, që lexohet i lidhur me nenin 4, paragrafi 1, të Vendimit 2004/849/KE¹⁰ dhe nenin 4, paragrafi 1, të Vendimit 2004/860/KE¹¹.

20. Neni 4, germa "b" dhe neni 9, germa "c" të kësaj rregulloreje përbëjnë dispozitat të hartuara në bazë të tërësisë së legjislacionit të Shengenit ose të lidhura me të sipas kuptimit të nenit 3, paragrafi 2, të Aktit të Aderimit 2003,

MIRATOJNË KËTË RREGULLORE:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

1. Kjo rregullore krijon një regjim të trafikut lokal kufitar në kufijtë e jashtëm tokësorë të shteteve anëtare dhe paraqet për këtë qëllim një leje për trafikun lokal kufitar.

2. Kjo rregullore autorizon shtetet anëtare të nënshkruajnë ose të ruajnë marrëveshje dypalëshe me vendet e treta fqinje me qëllim zbatimin e regjimit të trafikut lokal kufitar të përcaktuar nga kjo rregullore.

Neni 2

Objekti

Kjo rregullore nuk cenon dispozitat e legjislacionit të BE-së dhe kombëtar të zbatueshëm për shtetasit e vendeve të treta që kanë të bëjnë me:

- a) qëndrimet afatgjata;
- b) aksesin dhe ushtrimin e veprimtarisë ekonomike;
- c) çështjet doganore dhe tatimore.

Neni 3

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj rregulloreje përdoren përkufizimet e mëposhtme:

1. "kufi i jashtëm tokësor" është kufiri i përbashkët tokësor ndërmjet një shteti anëtar dhe një vendi të tretë fqinjë;

2. "zonë kufitare" është zona e cila ndodhet jo më larg se 30 kilometra nga vija kufiri. Njësitë vendore administrative që duhet të konsiderohen si pjesë e zonës kufitare duhet të

specifikohen nga shtetet përkatëse në marrëveshjet e tyre dypalëshe të përmendura në nenin 13. Në rast se ndonjë pjesë e kësaj njësie ndodhet mbi 30 larg nga vija kufitare, por jo më larg se 50 km, ajo sërish konsiderohet si pjesë e zonës kufitare;

3. "trafik lokal kufitar" është lëvizja e rregullt në një kufi të jashtëm tokësor që kryhet nga rezidentët kufitarë me qëllime qëndrimi në zonën kufitare, për shembull për arsye shoqërore, kulturore ose arsye ekonomike të arsyetuara ose për arsye familjare, për një periudhë që nuk kalon afatin kohor të parashikuar në këtë rregullore;

4. "persona që gëzojnë të drejtën komunitare të lëvizjes së lirë" janë:

I. qytetarë të Bashkimit Evropian sipas kuptimit që i jepet në nenin 17, paragrafi 1 të Traktatit themelues të Bashkimit Evropian dhe shtetas të vendeve të treta që janë anëtarë të familjes së një qytetari të Bashkimit Evropian që ushtron të drejtën e tij apo të saj për lëvizje të lirë, ndaj të cilit zbatohet Direktiva e Këshillit 2004/38/KE¹²;

II. shtetasit e vendeve të treta dhe anëtarët e familjes së tyre, cilado qoftë shtetësia e tyre, të cilët, në zbatim të marrëveshjes ndërmjet Komunitetit dhe shteteve të tij anëtare, nga njëra anë, dhe atyre vendeve të treta, nga ana tjetër, gëzojnë të drejta të lëvizjes së lirë të barasvlershme me ato të qytetarëve të Bashkimit Evropian;

5. "shtetas i një vendi të tretë" është çdo person që nuk është qytetar i Bashkimit Evropian sipas kuptimit të nenit 17, paragrafi 1 të traktatit themelues të Bashkimit Evropian dhe që nuk mbulohet nga pika 4;

6. "rezidentë kufitarë" janë shtetasit e vendeve të treta që kanë qenë rezidentë legjitimë në zonën kufitare të një vendi fqinjë të shtetit anëtar, për një periudhë të specifikuar në marrëveshjet dypalëshe të përmendura në nenin 13, që duhet të jetë së paku një vit. Në raste të veçanta dhe të arsyetuara siç duhet në këto marrëveshje dypalëshe, periudha e qëndrimit prej më pak se një vit po ashtu mund të konsiderohet si e përshtatshme;

7. "leje e trafikut lokal kufitar" është një dokument i veçantë, siç jepet në Kreun III, që u jep të drejtën rezidentëve kufitarë të kalojnë pikën e kalimit kufitar sipas regjimit të trafikut lokal kufitar;

8. "Konventa e Shengenit" është Konventa për zbatimin e marrëveshjes së Shengenit, datë 14 qershor 1985, ndërmjet qeverive të shteteve të Bashkimit Ekonomik të Beneluksit, Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Francës për eliminimin gradual të kontrolleve në kufijtë e tyre të përbashkët¹³.

KREU II

REGJIMI I TRAFIKUT LOKAL KUFITAR

Neni 4

Kushtet e hyrjes

Rezidentët kufitarë mund të kalojnë kufirin tokësor të shtetit anëtar fqinjë sipas regjimit të trafikut lokal kufitar, me kusht që ata:

a) të posedojnë lejen e trafikut lokal kufitar dhe nëse kërkohet nga marrëveshja dypalëshe përkatëse e përmendur në nenin 13, dokumentin apo dokumentet e vlefshme të udhëtimit;

b) të mos jenë persona për të cilët është lëshuar një alarm në Sistemin e Informacionit Shengen (SIS) me qëllim refuzimin e hyrjes së tyre;

c) të mos konsiderohen si rrezik për politikën publike, sigurinë e brendshme, shëndetin publik ose marrëdhëniet ndërkombëtare të ndonjërit prej shteteve anëtare dhe në veçanti kur në bazat kombëtare të të dhënave të shteteve anëtare nuk është lëshuar asnjë alarm me qëllim refuzimin e hyrjes për të njëjtat arsye.

Neni 5

Kohëzgjatja e qëndrimit në zonën kufitare

Marrëveshjet dypalëshe të përmendura në nenin 13 specifikojnë kohëzgjatjen maksimale të lejueshme për çdo qëndrim të pandërprerë sipas regjimit të trafikut lokal kufitar, e cila nuk duhet të jetë më shumë se tre muaj

Neni 6

Verifikimet në hyrje dhe në dalje

1. Shtetet anëtare kryejnë verifikime në hyrje dhe dalje për rezidentët kufitarë në mënyrë që të sigurohen se ata plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 4.

2. Asnjë vulë për hyrje dhe dalje nuk duhet të vendoset në lejen e trafikut lokal kufitar sipas regjimit të trafikut lokal kufitar.

3. Paragrafi 1 nuk cenon nenin 15.

KREU III

LEJA E TRAFIKUT LOKAL KUFITAR

Neni 7

Prezantimi i lejes së trafikut lokal kufitar

1. Me anë të kësaj rregulloreje prezantohet leja e trafikut lokal kufitar.

2. Vlefshmëria territoriale e lejes së trafikut lokal kufitar duhet të kufizohet në zonën kufitare të shtetit anëtar lëshues.

3. Leja e trafikut lokal kufitar mban fotografinë e mbajtësit të lejes dhe duhet të përmbajë së paku të dhënat në vijim:

a) emrin(at) mbiemrin(at), datën e lindjes, shtetësinë dhe vendin e qëndrimit të mbajtësit të lejes;

b) autoritetin lëshues, datën e lëshimit dhe periudhën e vlefshmërisë;

c) zonën kufitare në të cilën mbajtësi i lejes është i autorizuar të lëvizë;

d) numrin(at) e dokumentit ose dokumenteve të vlefshme të udhëtimit, siç përmendet në nenin 9, germa "a", që i jep të drejtën mbajtësit të saj të kalojë kufijtë e jashtëm.

Në të tregohet qartë se mbajtësi i saj nuk është i autorizuar të lëvizë jashtë zonës kufitare dhe se çdo abuzim do të jetë objekt i sanksioneve të parashikuara në nenin 17.

Neni 8

Karakteristikat e sigurisë dhe specifikimet teknike të lejes së trafikut lokal kufitar

1. Karakteristikat e sigurisë dhe specifikimet teknike të lejes së trafikut lokal kufitar janë në përputhje me dispozitat përkatëse të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 1030/2002, datë 13 qershor 2002 "Për përcaktimin e një formati uniform për lejet e qëndrimit për shtetasit e vendeve të treta"¹⁴.

2. Shtetet anëtare i përcjellin Komisionit dhe shteteve të tjera anëtare një model të lejes së trafikut lokal kufitar të hartuar në përputhje me paragrafin 1.

Neni 9

Kushtet e lëshimit

Lejet e trafikut lokal kufitar mund t'u lëshohen rezidentëve të cilët:

a) posedojnë dokument ose dokumente të vlefshme udhëtimi, siç përmendet në nenin 17, paragrafi 3, germa "a", të Konventës së Shengenit, që u jep atyre të drejtën të kalojnë kufirin;

b) paraqesin dokumente që vërtetojnë statusin e tyre si rezidentë kufitarë dhe ekzistencën e arsyeve legjitime për kalimin e shpeshtë të kufirit të jashtëm tokësor sipas regjimit për trafikun lokal kufitar;

c) nuk janë persona për të cilët është lëshuar një alarm në SIS me qëllim refuzimin e hyrjes së tyre;

d) nuk konsiderohen si rrezik për politikën publike, sigurinë e brendshme, shëndetin publik ose marrëdhëniet ndërkombëtare të ndonjërit prej shteteve anëtare dhe në veçanti kur në bazat kombëtare të të dhënave të shteteve anëtare nuk është lëshuar asnjë alarm me qëllim refuzimin e hyrjes për të njëjtat arsye.

Neni 10

Vlefshmëria

Leja e trafikut lokal kufitar duhet të jetë e vlefshme minimumi një vit dhe maksimumi pesë vite.

Neni 11

Tarifat e lëshimit

Tarifat që korrespondojnë me koston administrative të përpunimit të aplikimeve për lejen e trafikut lokal nuk duhet të tejkalojnë tarifat e vendosura për përpunimin e aplikimeve për vizat afatshkurtra me hyrje të shumëfishta.

Leja e trafikut lokal kufitar mund të lëshohet pa pagesë.

Neni 12

Mënyrat e lëshimit

1. Leja për trafikun lokal kufitar mund të lëshohet nga konsullata ose nga çdo autoritet administrativ i shtetit anëtar i caktuar në marrëveshjet dypalëshe të përmendura në nenin 13.

2. Shtetet anëtare mbajnë një regjistër qendror për aplikimet, lëshimet, zgjatjen dhe anulimin ose tërheqjen e lejeve të trafikut lokal kufitar dhe caktojnë një pikë kombëtare kontakti përgjegjëse për dhënien e menjëhershme të informacionit për lejet e regjistruara në këtë regjistër, sipas kërkesës së shteteve të tjera anëtare.

KREU IV

ZBATIMI I REGJIMIT TË TRAFIKUT LOKAL KUFITAR

Neni 13

Marrëveshjet dypalëshe ndërmjet shteteve anëtare dhe vendeve të treta fqinje

1. Për qëllim të zbatimit të regjimit të trafikut lokal kufitar, shtetet anëtare autorizohen të lidhin marrëveshje dypalëshe me vendet e treta fqinje në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë rregullore.

Shtetet anëtare mund të ruajnë gjithashtu marrëveshjet dypalëshe ekzistuese me vendet e treta fqinje për trafikun lokal kufitar. Në rastet kur këto marrëveshje janë në pajtim me këtë rregullore, shtetet anëtare përkatëse i ndryshojnë marrëveshjet, në një mënyrë të tillë që të eliminohen papajtueshmëritë e evidentuara.

2. Përpara se të lidhë ose ndryshojë një marrëveshje dypalëshe për trafikun lokal kufitar me një vend të tretë fqinj, shtetet anëtare në fjalë konsultohen me Komisionin për sa i përket papajtueshmërisë së marrëveshjes me këtë rregullore.

Nëse Komisioni gjykon se marrëveshja nuk përputhet me këtë rregullore, ai njofton shtetin anëtar në fjalë. Shteti anëtar ndërmerr të gjithë hapat e përshtatshëm për të ndryshuar

marrëveshjen brenda një periudhe të arsyeshme, në mënyrë të tillë që të eliminohen papajtueshmëritë e evidentuara.

3. Nëse BE-ja ose shteti anëtar përkatës nuk ka lidhur një marrëveshje të përgjithshme ripranimi me një vend të tretë, në marrëveshjet dypalëshe për trafikun lokal kufitar me këtë vend të tretë parashikohet lehtësimi i ripranimit të personave që konstatohen se abuzojnë me regjimin e trafikut lokal kufitar siç përcaktohet nga kjo rregullore.

Neni 14

Krahasueshmëria e trajtimit

Në marrëveshjet dypalëshe të përmendura në nenin 13, shtetet anëtare sigurohen që vendet e treta t'u japin shtetasve të vendeve të treta që gëzojnë të drejtën e lëvizjes së lirë në Komunitet dhe shtetasve të vendeve të treta që janë rezidentë të ligjshëm në zonën kufitare të shtetit anëtar përkatës, trajtim së paku të krahasueshëm me atë që u jepet rezidentëve kufitarë të vendit të tretë në fjalë.

Neni 15

Lehtësimi i kalimit kufitar

1. Marrëveshjet dypalëshe të përmendura në nenin 13 mund të parashikojnë lehtësimin e kalimit të kufirit, atëherë kur shtetet anëtare:

- a) përcaktojnë pika specifike të kalimit kufitar të hapura vetëm për rezidentët kufitarë;
- b) mbajnë korsi specifike rezervë për rezidentët kufitarë në pikat e zakonshme të kalimit kufitar; ose
- c) marrin në konsideratë rrethanat lokale, dhe kur në raste të veçanta, ekziston një kërkesë me natyrë të veçantë, autorizojnë rezidentët kufitarë të kalojnë kufirin e tyre të jashtëm tokësor në vende të caktuara, përveç pikave të autorizuar për kalimin kufitar dhe jashtë orarit të caktuar të punës.

2. Kur shteti anëtar vendos të lehtësojnë kalimin e kufirit për rezidentët kufitarë në përputhje me paragrafin 1, ai automatikisht lehtëson kalimin e kufirit për personat që gëzojnë të drejtën e lëvizjes së lirë në Komunitet dhe qëndrojnë në zonën kufitare përkatëse.

3. Në pikat e kalimit kufitar të përmendura në paragrafin 1, germa "a" dhe në korsitë e përmendura në paragrafin 1, germa "b", personat që kalojnë rregullisht kufirin e jashtëm tokësor dhe që, për shkak të kalimit të tyre të shpeshtë të kufirit, janë të njohur për rojat kufitare, zakonisht u nënshtrohen vetëm verifikimeve të rastit.

Këta persona u nënshtrohen herë pas here verifikimeve tërësore, pa paralajmërim dhe në intervale të çrregullta.

4. Kurs shteti anëtar vendos të lehtësojë kalimin e kufirit për rezidentët kufitarë në përputhje me paragrafin 1, germa "c":

a) Leja e trafikut lokal kufitar, përveç informacionit të kërkuar sipas nenit 7, paragrafi 3, përmban detaje të vendit dhe rrethanave sipas së cilave mund të kalohet kufiri i jashtëm tokësor;

b) Shtetet anëtare në fjalë kryejnë verifikime të rastit dhe mbikëqyrje të rregullta për të parandaluar kalimet e paautorizuara të kufirit.

KREU V

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Seuta dhe Melija

Dispozitat e kësaj rregulloreje nuk prekin rregullat e veçanta që zbatohen për qytetet e Seutës dhe Melijës, siç përcaktohet në Deklaratën e Mbretërisë së Spanjës për qytetet e Seutës dhe Melijës në Aktin Final të Marrëveshjes për Anëtarësimin e Mbretërisë së Spanjës në Konventën që zbaton Marrëveshjen e Shengenit.

Neni 17

Sanksionet

1. Shtetet anëtare sigurohen që çdo abuzim në lidhje me regjimin e trafikut lokal kufitar, siç përcaktohet në këtë rregullore dhe siç zbatohet nga marrëveshjet dypalëshe të përmendura në nenin 13, t'i nënshtrohet sanksioneve të parashikuara në legjislacionin e brendshëm.

2. Këto sanksione janë efektive, proporcionale dhe parandaluese, dhe përfshijnë mundësinë e anulimit dhe revokimit të lejeve të trafikut lokal kufitar.

3. Shtetet anëtare mbajnë një regjistër të të gjitha rasteve të abuzimeve në lidhje me trafikun lokal kufitar dhe të sanksioneve të vendosura në përputhje me paragrafin 1. Ky informacion i përcillet çdo gjashtë muaj shteteve të tjera anëtare dhe Komisionit.

Neni 18

Raporti për regjimin e trafikut lokal kufitar

Jo më vonë se 19 janari 2009, Komisioni i paraqet një raport Parlamentit Evropian dhe Këshillit për zbatimin dhe funksionimin e regjimit lokal kufitar, siç përcaktohet nga kjo rregullore dhe zbatohet nga marrëveshjet dypalëshe të lidhura dhe të mbajtura në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë rregullore. Raporti shoqërohet me propozime ligjore përkatëse, nëse është e nevojshme.

Neni 19

Njoftimi i marrëveshjeve dypalëshe

1. Shtetet anëtare njoftojnë Komisionin për të gjitha marrëveshjet e përmendura në nenin 13 dhe për çdo denoncim ose ndryshim të tyre.

2. Komisioni e vë informacionin e përcjellë në përputhje me paragrafin 1 në dispozicion të shteteve anëtare dhe të publikut, përmes botimit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian dhe përmes çdo mjeti tjetër të përshtatshëm.

Neni 20

Ndryshimi i dispozitave të Konventës së Shengenit

Dispozitat e nenit 136, paragrafi 3, të Konventës së Shengenit zëvendësohen si më poshtë:

"3. Paragrafi 2 nuk zbatohet për marrëveshjet dypalëshe për trafikun lokal kufitar të përmendura në nenin 13 të Rregullores (KE) nr. 1931/2006 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 20 dhjetor 2006, "Për rregullat mbi trafikun lokal kufitar në kufijtë e jashtëm tokësorë të shteteve anëtare".

Neni 21

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 20 ditë pas botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Kjo rregullore është detyruese në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha shtetet anëtare në përputhje me Traktatin themelues të Komunitetit Evropian.

Nënshkruar në Bruksel, më 20 dhjetor 2006.

Për Parlamentin Evropian

Presidenti

J. BORRELL FONTELLES

Për Këshillin

Presidenti

J. KORKEAOJA

1. Opinioni i Parlamentit Evropian i 14 shkurtit 2006 (ende i pabotuar në Gazetën Zyrtare) dhe Vendimi i Këshillit i 5 tetor 2006.

2. *Gazeta Zyrtare L 105, 13.4.2006, f. 1.*

3. *Gazeta Zyrtare L 81, 21.3.2001, f. 1.* Rregullore e ndryshuar së fundmi me Rregulloren (KE) nr. 851/2005 (*Gazeta Zyrtare L 141, 4.6.2005, f. 3*).
 4. Shih në këtë Gazetë Zyrtare.
 5. *Gazeta Zyrtare L 239, 22.9.2000, f. 69.*
 6. *Gazeta Zyrtare L 176, 10.7.1999, f. 36.*
 7. *Gazeta Zyrtare L 176, 10.7.1999, f. 31.*
 8. *Gazeta Zyrtare L 131, 1.6.2000, f. 43.*
 9. *Gazeta Zyrtare L 64, 7.3.2002, f. 20.*
 10. Vendimi i Këshillit 2004/849/KE, datë 25 tetor 2004, "Për nënshkrimin në emër të Bashkimit Evropian dhe për zbatimin e përkohshëm të disa dispozitave të marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian, Komunitetit Evropian dhe Konfederatës Zvicerane në lidhje me përfshirjen e Konfederatës Zvicerane në implementimin, zbatimin dhe zhvillimin e tërësisë së legjislacionit të Shengenit" (*Gazeta Zyrtare L 368, 15.12.2004, f. 26*).
 11. Vendimi i Këshillit 2004/860/KE, datë 25 tetor 2004, "Për nënshkrimin në emër të Komunitetit Evropian dhe për zbatimin e përkohshëm të disa dispozitave të marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian, Komunitetit Evropian dhe Konfederatës së Zvicrës në lidhje me përfshirjen e Konfederatës së Zvicrës në implementimin, zbatimin dhe zhvillimin e tërësisë së legjislacionit të Shengenit" (*Gazeta Zyrtare L 370, 17.12.2004, f. 78*).
 12. Direktiva 2004/38/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 29 prill 2004, "për të drejtën e qytetarëve të Bashkimit Evropian dhe anëtarëve të familjes së tyre për lirinë e lëvizjes dhe të banimit brenda territorit të shteteve anëtare" (*Gazeta Zyrtare L 158, 30.4.2004, f. 77*). Versioni i korigjuar në *Gazeta Zyrtare L 229, 29.6.2004, f. 35*.
 13. *Gazeta Zyrtare L 239, 22.9.2000, f. 19.* Konventa e ndryshuar së fundmi me Rregulloren (KE) nr. 1160/2005 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (*Gazeta Zyrtare L 191, 22.7.2005, f. 18*).
 14. *Gazeta Zyrtare L 157, 15.6.2002, f. 1.*
- * *Gazeta Zyrtare L 405, 30.12.2006*
-